

Leksion i hapur "Siguria Kibernetike në Epokën Digjitale" në Fakultetin Ekonomik

Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", u mbajt një leksion i hapur me temë "Siguria Kibernetike në Epokën Digjitale", në kuadër të aktiviteteve me Bordin Këshillimor të Biznesit, pranë këtij universiteti. Dekani i fakultetit, Prof.as.dr. Shpëtim Çerri, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të studentëve në këtë diskutim aktual dhe gjithëpërfshirës.

Temën e prezantuan dy ekspertë të sigurisë kibernetike, njëkohësisht anëtarë të Shoqatës së Bankave të Shqipërisë, Z. Reglend Xhango, menaxher i sigurisë në OTP Bank dhe kryetar i Komitetit të Sigurisë Kibernetike të AAB-së, si dhe znj. Entela Prifti, menaxhere e sigurisë në Raiffeisen Bank dhe anëtare e Komitetit të Sigurisë Kibernetike të AAB-së.

Pas prezantimit, studentët patën mundësinë të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë rreth sigurisë kibernetike, duke treguar interes dhe kuriozitet për këtë fushë.



